



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA HIMARË  
SEKTORI I PROKURIMEVE DHE PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Himarë , më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2026

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS-SHËRBIME**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE  
PËR KUALIFIKIM**

**OBJEKTI I PROKURIMIT: “SHPENZIME PER SUPERVIZIM”**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Sherbime per mbikqyrje te ndertimit 71521000-6**

**VLERA E FONDIT LIMIT : Fondi limit i përlogaritur për këtë kontratë/marrëveshje kuadër/Fondi limit i përlogaritur për këtë objekt siç është planifikuar në parashikimin buxhetor të Autoritetit/Entit Kontraktor (në rastin e marrëveshjeve kuadër ose kontratave shumëvjeçare) : Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 100,000,000 (Njëqind milione) pa tvsh. Ose 1,047,559 EUR (Një milion e dyzet e shtatë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë Euro ) pa TVSH me kursin e datës 13.05.2026 të BSH me vlerë 1 euro= 95.46 leke)**

**Viti 2026, 50,000,000 (peseedhjetë milione) lekë pa TVSH Ose 523,780 EUR (Pesëqind e njëzet e tre mijë e shtatëqind e tetëdhjetë. EUR) pa TVSH**

**Viti 2027, 33,333,333 (Tridhjetë e tre milionë e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre.) lekë pa TVSH Ose 349,186 EUR (Treqind e dyzet e nëntë mijë e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë. EUR) pa TVSH**

**Viti 2028, 16,666,667 (Gjashtëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë.) lekë pa TVSH Ose 174,593 EUR (Njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tre. EUR) pa TVSH**

**Perllogaritja e fondit limit dhe specifikimeve teknike** eshte kryer nga inxhinier i licensuar referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)”, Inxhinieri është mbështetur ne manualin teknik te çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre bazuar ne ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. - VKM nr. 216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe

funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve” - Udhëzimi nr.2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar. me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

## **VKM Nr. 354, datë 11.5.2016 “PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKËQYRJE DHE KOLAUDIM”**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Himarë** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

### **FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

#### **1. KRITERET E PËRZGJEDHJES TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

*Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.*

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

*a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar. Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- Sipas Shtojcës Nr. 9

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024, 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% vlerës së përlloragitur e kontratës që prokurohet.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2022, 2023, 2024 të shoqëruar me Aktin e Ekspertizës së Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur ato janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika “c”, të ligjit nr.. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të auditorit ligjor dhe kontabël të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ midis aktiveve. dhe detyrimet.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar sipas vlerës së fondit limit të kësaj procedure, sipas nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162/2020, si dhe neneve 43 dhe 47, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me qëllim që autoriteti kontraktor të kuptojë nëse operatorët ekonomikë ofertues kanë apo zotërojnë mundësitë e nevojshme financiare për të përmbyllur punët publike me sukses. Xhirot e tre viteve të fundit janë 2022, 2023, 2024, që rezulton të jenë përmbullur edhe sipas legjislacionit tatimor. Përqindja e kërkuar mbi xhiron vjetore është një përqindje minimale sipas RRPP-ve dhe xhiro e tre vjetëve e kërkuar, jo vetëm që përputhet me praktikën administrative të prokurimeve publike

të ndjekur deri më tani, por është e rëndësishme për të vlerësuar kapacitetin ekonomik të ofertuesit dhe kuptuar nëse është i aftë financiarisht për të përmbyllur punët publike pranë autoritetit kontraktor. Po kështu, që nga operatorët ekonomikë të vërtetohet kapaciteti ekonomik, ata mund të paraqesin kopje të bilanceve të tre viteve të fundit për vitet 2022, 2023, 2024, si mbas xhirove vjetore, të depozituar pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet, sipas ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar. Paraqitja e bilanceve është një mundësi, në rast se operatori ekonomik ofertues paraqet xhirot e kërkuara. Këto kërkesa të vendosura në DST (për mundësinë e paraqitjes së bilanceve dhe detyrimin e paraqitjes së dokumenteve për xhiron vjetore) përputhen edhe me nenin 9 të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, sipas të cilëve periudha e raportimit financiar është 12 muaj dhe periudha e depozitimit të pasqyrave financiare është nga 1215 muaj.

Gjithashtu, për të vërtetuar kapacitetin ekonomik, operatori ekonomik ofertues duhet të depozitojë vërtetim që konfirmon shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga pushteti lokal për tre vitet e fundit, në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore ku ai ushtron aktivitetin sipas të dhënave përkatëse të ekstraktit të QKR-së/QKB-së. Kjo kërkesë buron nga neni 76 i LPP-së, ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, si dhe ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, sipas të cilëve subjektet tregtare kanë detyrimin që të paguajnë taksat vendore, me qëllim që të ushtrojnë aktivitetin. Vitet përkojnë me 2022, 2023, 2024. Të gjitha kërkesat lidhur me kapacitetin ekonomik janë të bazuara në legjislacionin e përmendur më sipër dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse ofertuesit kanë kapacitete për të nisur dhe përfunduar punët publike që prokurohen. Po kështu, duke qenë se mund të marrin pjesë si ofertues edhe bashkime operatorësh ekonomikë, atëherë secili prej operatorëve ekonomikë të bashkuar, duhet të depozitojë dokumentacionin si më lart. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”; si dhe shkronjës c, të nenit 41 të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, ku parashikohet se: “Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: ... c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii. ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.”. Po kështu, kjo kërkesë bazohet edhe në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

### 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit

të kontratës, me një vlerë **jo më të vogël se 30% e vlerës së përllogaritur** të objektit që prokurohet.

- a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.
- b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

*Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtyre kritereve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 20 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose në vlerën limit të kontratës për punët totale të ngjashme të kryera në 3 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Këto vlera janë vlerat minimale të kërkuara sipas RRPP-ve. a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e shërbimit; vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës; Situacion Përfundimtar dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të kuptuar nëse ofertuesi ka qenë i angazhuar në veprimtari ndërtimore të ngjashme, i ka përmbyllur me sukses këto punë, si dhe ka kapacitet teknik për të përmbyllur punët që prokurohen nga autoriteti kontraktor. b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratë Shërbimi dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të kuptuar nëse ofertuesi ka qenë i angazhuar në veprimtari ndërtimore të ngjashme pranë subjekteve private, i ka përmbyllur me sukses këto punë, si dhe ka kapacitet teknik për të përmbyllur punët që prokurohen nga autoriteti kontraktor. Dokumentet e mësipërme janë të mbështetura edhe në legjislacionin në fuqi të zbatueshëm për ndërtimet. Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet, që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE. Kjo kërkesë bazohet në nenin 88 e në vijim të LPP.,

### **2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor Drejtues Teknik (drejtues teknik i shoqërisë për mbikëqyrje e kolaudim I perfshire ne licencen e shoqerise, dhe i pajisur me licencë**

**profesionale individuale në fushat respektive si dhe te figuroje ne listpagesen e shoqerise për të paktën tre muajt e fundit), si më poshtë:**

<b>Nr.</b>	<b>TITULLI</b>
1	1 ( nje) Inxhinier profili Rruge Ura/Infrastruktura Transporti
2	1 ( nje) Inxhinier Mekanik
3	1 ( nje) Inxhinier Ndertimi Strukturist/Civile
4	1 ( nje) Inxhinier Elektrik
5	1 ( nje) Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder
6	1 ( nje) Inxhinier Gjeolog
7	1 ( nje) Inxhinier Arkitekt
8	1 ( nje) Inxhinier Elektronik/Elektroteknik
9	1 ( nje) Inxhinier Hidroteknik

**\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.**

**Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:**

- Kontratë pune të vlefshme
- Licencë profesionale individuale për mbikëqyrje e kolaudim,
- Diplomë
- Librezë pune
- CV

**Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016” - lidhja 4 “kushte dhe kritere specifike që kryesisht duhen plotësuar për të fituar kategoritë në fushat e studimit dhe projektimit

Kriteri i mësipërm është vendosur në përputhje me natyrën, kompleksitetin dhe objektin e kontratës, me qëllim garantimin e realizimit të shërbimeve të mbikëqyrjes dhe kolaudimit sipas standardeve teknike, ligjore dhe profesionale në fuqi.

Objekti i kontratës përfshin komponentë të ndryshëm teknikë dhe inxhinierikë, të cilët kërkojnë angazhimin e një stafi multidisiplinar të kualifikuar, për të siguruar kontrollin e cilësisë së

punimeve, respektimin e projektit, standardeve teknike, preventivave, si dhe zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi në fushën e ndërtimit dhe infrastrukturës.

Kërkesa që personeli të jetë pjesë e licencës së shoqërisë, i pajisur me licencë profesionale individuale dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën tre muajt e fundit, vendoset për të garantuar:

- disponueshmërinë reale dhe efektive të stafit gjatë gjithë periudhës së realizimit të kontratës;
- kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit ekonomik;
- shmangien e deklarimeve formale apo angazhimeve fiktive të personelit;
- përgjegjshmërinë profesionale dhe ligjore të ekspertëve të përfshirë në realizimin e shërbimeve.
- Përfshirja e profileve të kërkuara argumentohet si më poshtë:
- Inxhinieri i Rrugëve/Ura/Infrastrukturë Transporti është i domosdoshëm për mbikëqyrjen dhe kontrollin e punimeve që lidhen me infrastrukturën rrugore, sistemet, akseset dhe elementët e transportit.
- Inxhinieri Mekanik kërkohet për verifikimin e instalimeve dhe pajisjeve mekanike, sistemeve teknologjike dhe elementëve mekanikë të objektit.
- Inxhinieri Strukturist/Civil është i nevojshëm për kontrollin e elementëve strukturorë, sigurisë statike dhe zbatimit korrekt të projektit konstruktiv.
- Inxhinieri Elektrik garanton mbikëqyrjen e instalimeve elektrike, sistemeve të furnizimit me energji dhe respektimin e standardeve të sigurisë elektrike.
- Inxhinieri Gjeodet/Topograf/Markshajder është i domosdoshëm për verifikimet topografike, rakordimet në terren, kuotat dhe kontrollin e volumeve të punimeve.
- Inxhinieri Gjeolog kërkohet për vlerësimin e kushteve gjeologjike dhe gjeoteknike të terrenit, me ndikim të drejtpërdrejtë në sigurinë dhe qëndrueshmërinë e veprës.
- Arkitekti është i nevojshëm për kontrollin e zbatimit të projektit arkitektonik, funksionalitetit, estetikës dhe harmonizimit të elementëve ndërtimorë.
- Inxhinieri Elektronik/Elektroteknik kërkohet për mbikëqyrjen e sistemeve elektronike, automatike, kontrollit, monitorimit dhe rrjeteve teknologjike të objektit.
- Inxhinieri Hidroteknik është i domosdoshëm për kontrollin e sistemeve hidraulike, drenazhimit, furnizimit me ujë, kanalizimeve dhe mbrojtjes nga ujërat.

Ky kriter është në përpjesëtim të drejtë me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe nuk kufizon konkurrencën, pasi kërkon vetëm personelin minimal të nevojshëm për realizimin me cilësi dhe siguri të shërbimeve objekt prokurimi.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin Staf Mbeshtetes i pajisur me licencë profesionale individuale për mbikëqyrje e kolaudim, në fushat respektive, si dhe të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, si më poshtë:

- **1 (nje)** Inxhinier Ndërtimi.
- **1 (nje)** Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder.
- **1 (nje)** Inxhinier Mjedisi/Kimist Teknolog.

**Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:**

- Kontratë pune të vlefshme
- Licencë profesionale individuale për mbikëqyrje e kolaudim,
- Diplomë
- Librezë pune
- CV

**Argumentimi:** AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Stafi inxhinierik që do të realizojë mbikëqyrjen është kërkuar në përputhje me stafin inxhinierik të nevojshëm për zbatimin e punimeve, zërat përkatës të preventivit si dhe me projektin e zbatimit të punimeve.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **14 (katërmbëdhjete)** persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për të paktën tre muajt e fundit, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

**\*\*\* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 10. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.**

**Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:**

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për të paktën tre muajt e fundit
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për të paktën tre muajt e fundit

**Argumentimi:** Këto kërkesa për stafin janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 4, gërma ”c” të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me grafikun të shërbimeve.

Gjithashtu Njësia e Prokurimit për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore dhe stabilitetin e saj ka kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në pikën 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” sipas së cilës: ”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin , si dhe te figuroje ne listpagesen e shoqerise për të paktën tre muajt e fundit), si më poshtë:

- a) Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin **1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin**, në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit, të deklaruar nga data e hapjes së ofertave ose me kontraktim . *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, Grupimi duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin).*
- b) Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin **1 (një) specialist Ekspert "PËRGJEGJËS PËR SIGURINË DHE MBROJTJEN E SHËNDETIT NË PUNË"**., në përputhje me klauzolat Ligjit Nr 10327 date 18/02/2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 " Për sigurinë në kantier";, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplomë/certifikatë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi për 3 muajt e fundit, të deklaruar nga data e hapjes së ofertave ose me kontraktim . *(Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, Grupimi duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist Ekspert "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë"*.

**Argumentimi:** Për shkak të natyrës së punimeve që kryhen shihet e nevojshme dhe e domosdoshme prania e 1 (një) punonjes te pajisur me çertifikate Ekspert Zjarrfikës, ne zbatim të Ligjit Nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, dhe 1(një) punonjësi për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, ne zbatim te ligjit Nr 10327 date 18/02/2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 " Për sigurinë në kantier";

## 2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 **Operatori/et ekonomik/ë duhet të paraqesin certifikatat e cilësisë së punimeve, të vlefshme (ose ekuivalente) për objektin që prokurohet, si më poshtë:**

- **ISO 9001:2015** ( të vlefshme, ose ekuivalente), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën
- **ISO 14001:2015** ( të vlefshme, ose ekuivalente), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën
- **ISO 45001:2018/45001-2023** ( të vlefshme, ose ekuivalente), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën
- **ISO 39001:2012**( të vlefshme, ose ekuivalente), e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën

**Argumentim:** Kërkesa për paraqitjen e certifikatave ISO është vendosur në funksion të garantimit të cilësisë, sigurisë, menaxhimit mjedisor dhe standardeve profesionale gjatë realizimit të shërbimeve objekt kontrate, në përputhje me natyrën dhe kompleksitetin e procedurës së prokurimit. Këto certifikime dëshmojnë se operatori ekonomik disponon sisteme menaxhimi të konsoliduara dhe të certifikuara sipas standardeve ndërkombëtare, duke garantuar realizimin e kontratës me cilësi, efikasitet dhe përgjegjshmëri.

Konkretisht:

- ISO 9001:2015 kërkohet për të garantuar që operatori ekonomik zbaton një sistem të menaxhimit të cilësisë, i cili siguron organizimin, kontrollin dhe monitorimin e proceseve të punës, me qëllim realizimin korrekt dhe cilësor të shërbimeve objekt kontrate. Ky standard garanton aftësinë e operatorit për të ofruar shërbime në përputhje me kërkesat teknike, ligjore dhe kontraktuale.
- ISO 14001:2015 kërkohet për të garantuar që operatori ekonomik disponon politika dhe procedura për menaxhimin mjedisor, minimizimin e ndikimeve negative në mjedis dhe respektimin e standardeve mjedisore gjatë realizimit të shërbimeve. Duke qenë se aktivitetet e mbikëqyrjes dhe kolaudimit lidhen me ndërhyrje infrastrukturore dhe ndërtimore, ky standard konsiderohet i nevojshëm për garantimin e praktikave të qëndrueshme dhe respektimin e legjislacionit mjedisor.
- ISO 45001:2018 / ISO 45001:2023 kërkohet për të garantuar që operatori ekonomik zbaton standarde për sigurinë dhe shëndetin në punë, duke minimizuar rreziqet profesionale për stafin teknik dhe palët e përfshira në realizimin e kontratës. Ky standard është veçanërisht i rëndësishëm për kontrata që lidhen me monitorimin e punimeve ndërtimore dhe infrastrukturore, ku ekzistojnë rreziqe teknike dhe operacionale.
- ISO 39001:2012 kërkohet për të garantuar që operatori ekonomik disponon sisteme menaxhimi për sigurinë në trafikun rrugor, veçanërisht në kontrata që lidhen me infrastrukturën rrugore, transportin, lëvizjen e mjeteve dhe menaxhimin e sigurisë rrugore

gjatë realizimit të punimeve. Ky standard ndihmon në reduktimin e rreziqeve dhe incidenteve që lidhen me qarkullimin dhe sigurinë në rrugë.

Kërkesa që certifikatat të jenë të vlefshme dhe të lëshuara nga organizma të akredituar nga DPA ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, vendoset për të garantuar vlefshmërinë, besueshmërinë dhe njohjen ligjore të certifikimeve të paraqitura.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kërkesa që secili anëtar të paraqesë certifikatat përkatëse argumentohet me faktin se çdo anëtar i BOE-së do të jetë pjesëmarrës në realizimin e kontratës dhe duhet të dëshmojë se disponon standardet minimale të menaxhimit dhe sigurisë në fushën përkatëse të aktivitetit që do të kryejë.

Ky kriter është në përpjesëtim të drejtë me objektin dhe rëndësinë e kontratës dhe synon garantimin e realizimit të shërbimeve sipas standardeve të kërkuara teknike, mjedisore dhe të sigurisë.

**Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

## **NJESIA E PROKURIMIT**